

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 30.11.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 56, “Përfashtime të veçanta në import”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 28 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“... përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar.”.
2. Pas pikës 42 shtohet pika 43, me këtë përmbajtje:
“43. Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

Neni 2

Fjalja e dytë, e pikës 2, të nenit 77, shfuqizohet.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama